

8. Treguesit mjedisor të peshkatarisë

Kosova, krahas shumë sektorëve tjerë, ka potenciale të mëdha edhe për zhvillimin e sektorit të peshkatarisë. Ujërat sipërfaqësore dhe kushtet e përshtatshme klimatike që ka vendi, e bëjnë peshkatarinë njërin nga sektorët më atraktiv për investime.

8.1. Vlerësimi i biomasës së fondit peshkor dhe kuotave të lejuara për peshkim

Emri i treguesit	Vlerësimi i biomasës së fondit peshkor dhe kuotave të lejuara për peshkim
Kodi i treguesit	PE01
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i gjendjes
Përshkrimi i treguesit	Me treguesin paraqitet gjendja e biomasës dhe niveli i shfrytëzimit të fondit të peshkut në nivel kombëtar.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Treguesi përcaktohet në bazë të pjesëmarrjes procentuale të llojeve ekonomikisht të rëndësishme të peshkut në kuadër të vlerësimit të përfitimit të qëndrueshme maksimal. Llogaritja e parametrave të dinamikës së popullatës bëhet bazuar në rritjen, vdekshmërinë, karakteristikat riprodhuese, shpërndarjen hapësinore, vlerësimin e biomasës, etj.
Njësia matëse	Vlerësimi i biomasës dhe shpërndarja e saj shprehur në kilogram gjegjësisht kilogram për metër katror kg /m ² . Të dhënat për vlerën totale vjetore të peshqve të zënë, peshkimi vjetor sipas grupeve dhe peshkimi vjetor sipas llojeve të veçanta paraqiten grafikisht.
Burimi i të dhënave	Organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështje të bujqësisë ose organi administrativ përgjegjës për statistika.
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore, deri me 1 mars të vitit aktual, duhet të dërgohen të dhënat për vitin paraprak.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, numri i subjekteve të licencuara që merren me kultivimin e peshkut është 30 sosh me një kapacitet prej 10 deri në 300 ton. Nga kjo veprimtari, brenda vitit prodhohen rreth 600 ton troftë që kryesisht tregtohen për konsum të brendshëm.